



Funded by
the European Union
Финансирано од
Европска Унија



Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
O M B U D S M A N



Децата на
1-во место!
Stand up 4
Children Rights!



ФОНДАЦИЈА ЗА ОБРАЗОВНИ И КУЛТУРНИ ИНИЦИЈАТИВИ
FOUNDATION FOR EDUCATION AND CULTURAL INITIATIVES
ЧЕКОР ПО ЧЕКОР • STEP BY STEP
Educating children • Strengthening professionals • Building the future

Децата на 1-во место! / Stand up 4 Children Rights!

TË DREJTAT E FËMIJËVE TANË NË SHKOLLAT TONA
Hulumtim për të qenit të informuar për Konventën për të Drejtat e fëmijës,
pjesëmarrja e nxënësve dhe siguria në shkollat fillore të RMV-së

KONTAKT INFO:

Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas hapi”

Bul. “Partizanski odredi” nr. 72a mezanin, Shkup

Tel/Faks: +389 2 3077 900

www.stepbystep.org.mk

Suzana Pecakovska, menaxhere e projektit Suzana.pecakovska@stepbystep.org.mk

Natasha Angjeleska, menaxhere e projektit natasa@stepbystep.org.mk

Avokati i Popullit

rr. “Makedonija” nr. 19, Shkup

tel: 389 02 129 327, 389 02 129 335

www.ombudsman.mk

E-mail: contact@ombudsman.mk

Vaska Bajramovska – Mustafa, këshilltare shtetërore ybmustafa@ombudsman.mk

Hulumtimi u realizua nga Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas hapi” në bashkëpunim me Avokatin e Popullit/Departamentin për të Drejtat e Fëmijëve në kuadër të projektit Fëmijët në vend të parë! me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e Fondacionit për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas hapi” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e BE-së.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin kur vendi ynë shënon 30 vjet nga ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm Konventa), Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas Hapi” së bashku me Avokatin e Popullit realizoi një hulumtim gjithëpërfshirës mbi të drejtat e fëmijës. Hulumtimi është realizuar si pjesë e projektit "Fëmijët në vendin e parë!" financuar nga Bashkimi Evropian (Programi Tematik për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci). Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë dhe të promovojë respektimin e të drejtave të fëmijëve si një parakusht për komunitetet demokratike të shkollave që ndërtojnë dhe kultivojnë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të shqyrtojë qëndrimet dhe mendimet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve nga shkollat fillore të vendit me mësim në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, boshnjake dhe serbe për njohjen dhe respektimin e Konventës dhe zbatimin e saj në shkolla, si dhe për të marrë njohuri për kushtet dhe praktikën në shkolla në lidhje me pjesëmarrjen e nxënësve në vendimmarrje, sigurinë dhe dhunën në shkollë, në hapësirën online dhe në mjedisin e tyre të afërt.

Metodologjia e hulumtimit përfshinte: 1) Hulumtime në zyrë dhe analiza të dokumenteve përkatëse, kornizës ligjore dhe dokumenteve strategjike që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve; 2) Anketa elektronike me nxënës, mësimitdhënës dhe prindër, e cila është realizuar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga shkollat e ndryshme fillore nga të gjitha rajonet e Maqedonisë; dhe 3) Tre fokus grupe me nxënës, mësimitdhënës dhe prindër. Analiza e dokumentacionit përfshinte gjithsej 27 dokumente, përkatësisht ligje, dokumente strategjike, plane veprimi, programe, koncepte, raporte, analiza dhe artikuj në media që u vlerësuan si relevante. Përmes anketës janë përfshirë 648 nxënës nga 75 shkolla fillore nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë, 325 mësimitdhënës lëndorë nga 79 shkolla nga 39 komuna dhe 541 prindër. Pyetësorët për të tre grupet e të anketuarve janë përkthyer në të gjitha gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi (maqedonisht, shqip, turqisht, serbisht dhe gjuhë boshnjake). Në hulumtim janë realizuar edhe tri fokus grupe, të cilat kanë përfshirë gjithsej 10 prindër, 12 mësimitdhënës dhe 16 nxënës. Mostra është realizuar sipas metodës së mostrës pa përzgjedhje të rastësishme dhe me përfaqësim të një shpërndarjeje adekuate të të anketuarve sipas gjinisë, moshës, rajonit dhe përkatësisë etnike.

Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti duhet t'u shërbejnë të gjithë aktorëve duke përfshirë pushtetin qendror dhe vendor, autoritetet arsimore, institucionet e tjera shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, shkollat, mësimitdhënësit dhe prindërit me qëllim që të përmirësohen politikat dhe praktikën që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve në vend.

TË QENIT I INFORMUAR DHE NJOHJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Në këtë fushë tematike, u hulumtua njohja e përgjithshme e të drejtave të fëmijëve dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës nga nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit, perceptimet dhe qëndrimet e tyre për rëndësinë e disa të drejtave për fëmijët, si dhe respektimi dhe zbatimi i tyre në kontekst shkollor.

Gjetjet kryesore të kërkimit

Nxënësit e përfshirë në hulumtim kanë njohuri/të informuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm Konventa) dhe këto njohuri zakonisht i marrin në kuadër të mësimitdhënies formale, pra gjatë orëve të mësimit. Pothuajse gjysma e nxënësve (48.3%) deklaruan se janë të njohur me Konventën, ndërsa 37% e nxënësve pjesërisht kanë njohuri. Këto të dhëna tregojnë se ka ende disa nxënës që kanë nevojë për njohuri të mëtejshme për të drejtat e fëmijës përmes aktiviteteve formale dhe joformale. Shumica e prindërve gjithashtu kanë njohuri për Konventën (47%), ndërsa 94% e mësimitdhënësve deklarojnë se e përdorin Konventën në punën e tyre.

Sipas nxënësve, të drejtat e fëmijës përgjithësisht respektohen në shkollë (vlera mesatare është 3.87 në një shkallë ku 1 = nuk respektohet fare, kurse 5 = respektohet plotësisht). Prindërit pajtohen me qëndrimin e nxënësve (vlera mesatare 3,76), ndërsa mendimi i mësimitdhënësve është se të drejtat e fëmijës respektohen plotësisht në shkollë (vlera mesatare 4,61). Shumica e nxënësve dhe prindërve përgjithësisht besojnë se mësimitdhënësit kanë njohuri për të drejtat e fëmijëve, si dhe se ata respektojnë të drejtat e fëmijëve në shkollë dhe i mbështesin fëmijët në ushtrimin e të drejtës së tyre për të marrë pjesë. Mirëpo, përkundër ekzistencës së një niveli të caktuar njohurish të mësimitdhënësit për të drejtat e fëmijëve, nxënësit dhe prindërit pohojnë se mësimitdhënësit kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme për njohjen më të mirë me të drejtat e fëmijëve.

Mësimitdhënësit e vlerësojnë veten lart kur bëhet fjalë për njohuritë dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe njohuritë e tyre për politikën arsimore që rregullojnë të drejtat e fëmijëve. Ata deklarojnë se kanë njohuri thuajse të plota për të drejtat e fëmijëve, se respektojnë të drejtat e fëmijëve në tërësi dhe kanë njohuri për politikën arsimore që rregullojnë të drejtat e fëmijëve. Mësimitdhënësit janë pak më kritikë ndaj njohurive të kolegëve të tyre mësimitdhënës, por megjithatë mendojnë se kanë njohuri të mira edhe për të drejtat e fëmijëve, respektojnë pothuajse plotësisht të drejtat e tyre dhe njohin politikën arsimore që rregullojnë të drejtat e fëmijëve. Sa i përket udhëheqësisë së shkollës, mësimitdhënësit konsiderojnë se ajo mbështet ndjeshëm pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje dhe se zbaton me sukses politikën e shkollës që rregullojnë të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu, mësimitdhënësit mendojnë se

nxënësit në shkollën e tyre i njohin shumë mirë të drejtat e fëmijës.

Sipas më shumë se gjysmës së mësimdhënësve (51,7%), **të drejtat e parashikuara në Konventë janë pjesërisht të përfaqësuara në plan programet dhe materialet** sipas të cilave ata punojnë. Ky qëndrim mes mësimdhënësve është vërejtur edhe në anketat e mëparshme – të kryera nga viti 2009 e këndeje dhe ky qëndrim mbetet i pandryshuar edhe sot. Kjo e dhënë tregon se pavarësisht ndërgjegjësimit dhe progresit në njohuritë për të drejtat e fëmijës të fëmijët, por edhe të kuadri arsimor dhe prindërit, përshtatja e mëtejshme e përmbajtjes së Konventës në planet dhe programet mësimore sipas moshës së nxënësve është ende të nevojshme.

Për shumicën e fëmijëve të përfshirë në hulumtim, **e drejta më e rëndësishme** është e drejta për jetë (42%). Kjo pasohet nga e drejta për të thënë atë që mendojnë (19%) dhe e drejta për mbrojtje nga dhuna (13%). Nga ana tjetër, pothuajse një e treta e nxënësve deklarojnë se **disa të drejta u janë shkelur në shkollë** dhe të drejtat më të shkelura janë e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje (36%), e drejta e fëmijëve për të thënë atë që mendojnë (32.5%) dhe e drejta e mbrojtjes nga dhuna (18.9%). Kjo çon në përfundimin se ato të drejta që janë më të rëndësishme për fëmijët gjithashtu shkelen më shpesh në mjedisin shkollor dhe se shkolla në një masë të caktuar ua kufizon lirinë fëmijëve për të thënë atë që mendojnë dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje.

Shërbimet profesionale në shkolla, sipas detyrimeve të tyre ligjore dhe të drejtave të veprimit, janë instanca e parë dhe rrjedhimisht përgjegjëse të drejtpërdrejta për të vepruar në rast të shkeljes së të drejtave të fëmijës. Megjithatë, hulumtimi tregoi se **besimi i nxënësve dhe prindërve në shërbimet profesionale** është i ulët. Domethënë, pjesa më e madhe e nxënësve (32,9 %) dhe pjesa më e madhe e prindërve (68,4 %) kanë besimin më të madh te kujdestarët e klasës dhe tek ata do të drejtoheshin së pari në rast të shkeljes së të drejtës së fëmijës, pastaj pason drejtori i shkollës, kurse në vend të tretë sipas shkollës së besimit janë shërbimet profesionale.

RESPEKTIMI I MENDIMIT TË FËMIJËS

Në kuadër të kësaj fushe tematike u hulumtua përfshirja dhe mekanizmat për pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje (kryetari i klasës dhe parlamenti i nxënësve) dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë, si avokati i nxënësve.

Gjithashtu u kontrollua perceptimi (njohuria/opinioni) i nxënësve, mësimit dhe prindërve për Avokatin e popullit si mekanizëm dhe autoritet nacional që mbron të drejtat e qytetarëve, përfshirë të drejtat e fëmijëve.

Nxënësit kanë perceptime të ndryshme për mënyrën se si merren **vendimet në shkollë**. Shumica e tyre (28%) konsiderojnë se të rriturit marrin vendime së bashku me nxënësit, por edhe një pjesë (22%) tregojnë se të rriturit marrin vendime pa u pyetur dhe përfshirë fëmijët. Te mësimitdhënësit dhe prindërit dominojnë perceptimet pozitive se fëmijët duhet të përfshihen në vendimmarrje, por edhe se në praktikë ka situata në të cilat fëmijët nuk përfshihen gjithmonë në vendimmarrje.

Mësimitdhënësit deklarojnë se ata shpesh kërkojnë mendimet e nxënësve kur marrin vendime që kanë të bëjnë me mësimitdhënien. Praktikrat e **përfshirjes së përfaqësuesve të nxënësve në organet e shkollës** nuk tregojnë një zbatim të qëndrueshëm dhe thelbësor të së drejtës së nxënësve për të marrë pjesë në vendimmarrje, në përputhje me Ligjin për arsimin fillor. Sipas 42% të mësimitdhënësve, Këshillat arsimore konsultohen me nxënësit ndonjëherë (tri ose më shumë herë). Të njëjtin qëndrim kanë edhe mësimitdhënësit (32%) për përfshirjen e nxënësve në këshillin shkollor. Në përgjithësi, nuk ka rregullsi dhe sistematikë në pjesëmarrjen e fëmijëve në punën e Këshillit të arsimtarëve, Këshillit të shkollës dhe Këshillit të prindërve. Këtë e vërtetojnë edhe përvojat e nxënësve të cilët përgjithësisht nuk e dinë ose nuk janë të informuar se si janë përfshirë përfaqësuesit e tyre në organet e shkollës.

Një shumicë e konsiderueshme e nxënësve (86%) **njohin dhe ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë** në zgjedhjen e kryetarit të klasës së tyre. Edhe pse shumica e nxënësve (52%) konfirmojnë se zgjedhja e kryetarit/kryetares është bërë në përputhje me kërkesat ligjore, përvojat e 48% të nxënësveve tregojnë se **zgjedhja e kryetarit/kryetares së klasës** nuk është bërë sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin dhe Udhëzuesin për pjesëmarrjen e nxënësve, organizimin e nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore, por në mënyra të tjera. Në lidhje me opsionet e tjera për pjesëmarrje në vendime si përmbajtja e mësimitdhënies, zgjedhja e një vendi për një ekskursion, nevoja për aktivitete edukative shtesë, një shfaqje vjetore, etj. është evidente se përvoja e nxënësve për të marrë pjesë në këtë lloj vendimesh është dukshëm më e vogël. Mësimitdhënësit, nga ana tjetër, raportojnë për disa lloje vendimesh që përfshijnë nxënësit, si cilësia e mësimitdhënies së rregullt, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për lavdërime dhe çmime për studentët, zgjedhja e lëndëve me zgjedhje, zgjedhja e aktiviteteve jashtëshkollore, seksionet, zgjedhja e mësimitdhënësit të vitit, për cilësinë e vlerësimit, transportin e nxënësve, zgjedhjen e situatave të konfliktit, përzgjedhjen e menysë për një vakt të organizuar, për rregullimin ekologjik të shkollës dhe klasave etj.

Nxënësit nuk e kanë praktikën e inicimit të aktiviteteve në shkollë. Të dhënat tregojnë **një nivel të ulët të aktivizimit** ku një pjesë shumë e vogël e nxënësve, vetëm 13%, deklaruan se kanë iniciuar ndonjë aktivitet/projekt që synon përmirësimin e jetës në shkollë. Megjithatë, është pozitive që shumica e prindërve (64%) mbështesin që fëmija i tyre të jetë aktiv në aktivitetet jashtëshkollore në shkollë.

Sa i përket organizimit të nxënësve, shumica e nxënësve (57%) deklaruan se në shkollën e tyre **zgjidhet rregullisht parlamenti i nxënësve**. Megjithatë, gati një e treta e nxënësve deklarojnë se nuk janë të informuar për zgjedhjen e parlamentit të nxënësve, çka tregon për mungesë transparence apo mos ekzistencë të një procedure për zgjedhjen e parlamentit. Nga ana tjetër, 285 nga 298 shkolla (ose 95,64%) të përfshira në anketën e Avokatit të Popullit¹ për vitin 2021, kanë dhënë përgjigje të ndryshme, duke u shprehur se kanë krijuar një Parlament të nxënësve. Kjo tregon nevojën për ndërgjegjësim më të madh të nxënësve, përkatësisht promovim më të gjerë dhe përfshirje më të madhe të të gjithë faktorëve të shkollës në formimin e Parlamentit të nxënësve.

Sa i përket **funksionalitetit të parlamenteve të nxënësve**, nxënësit dhe mësimitdhënësit kanë pikëpamje të ndryshme. Pothuajse gjysma e nxënësve (46.1%) nuk e dinë nëse mësimitdhënësit janë të përfshirë në mbështetjen e punës së parlamentit të nxënësve, ndërsa nga ana tjetër më shumë se gjysma e mësimitdhënësve (52%) deklarojnë se mësimitdhënësit në shkollën e tyre ofrojnë rregullisht mbështetje të konsiderueshme për parlamentin e nxënësve. Këto gjetje ndiqen nga fakti se pothuajse gjysma e mësimitdhënësve (45.5%), megjithëse janë mjaft të sigurt në njohuritë e tyre në lidhje me zbatimin e të drejtës së fëmijëve për të marrë pjesë në shkollë, në 3 vitet e fundit nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim që ka të bëjë me të drejtën e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në shkollë, ndërsa 43.1% ndonjëherë kanë marrë pjesë (një deri në dy trajnime). Vlen të theksohet se trajnime të tilla kryesisht realizohen nga organizata të shoqërisë civile.

Më tej, një pjesë e vogël e nxënësve (16%) janë të përfshirë në aktivitetet e parlamentit të nxënësve dhe 40.6% e nxënësve theksojnë se pjesëmarrja në punën e parlamentit të nxënësve është e kufizuar vetëm për kryetarët e bashkësisë së klasave, për shkak të së cilës shumica e tyre dhe nuk janë të përfshirë në punën e parlamentit. Te nxënësit ekziston një motiv dhe dëshirë për t'u përfshirë në punën e parlamentit të nxënësve dhe lloji më i nevojshëm i mbështetjes është edukimi i mëtejshëm për Konventën. Pothuajse gjysma e nxënësve shprehen se nuk e dinë nëse parlamenti i nxënësve merr pjesë në organet e shkollës, gjë që tregon se **ka nevojë për një informim të shtuar** të nxënësve për rolin e parlamentit të nxënësve, shkallën e pjesëmarrjes së parlamentit në organet e shkollës, si dhe informacion mbi rezultatin e pjesëmarrjes. Të tre grupet e të anketuarve kanë pikëpamje të ngjashme se cilat janë tre përfitimet më të mëdha të praktikimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje, ku më së shpeshti shprehen: ndërtimi i vetëdijes demokratike të nxënësve, pavarësia dhe mbështetja te vetja dhe marrja e vendimeve të informuara në lidhje me arsimin e ardhshëm, rrugën e karrierës, punësim.

Për sa i përket **avokatit të nxënësve** si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në shkollë brengos fakti që shumica e nxënësve (60%) kanë deklaruar se në shkollën e tyre nuk ka, apo nuk e dinë nëse ka avokat të nxënësve. Përkundër kësaj, 79% e shkollave të përfshira në sondazhin e kryer në vitin 2021, nga Avokati i Popullit (shih fusnotën 1) deklaruan se kanë themeluar një avokat të nxënësve. Ky dallim në të dhëna shtron pyetjen për mënyrën e përzgjedhjes së avokatit të nxënësve dhe pjesëmarrjen e nxënësve në atë proces, si dhe nevojën për vetëdijësim më të madh të nxënësve për mekanizmin e avokatit të nxënësve. Gjithashtu, ky konstatim tregon nevojën për përmirësimin e zbatimit të Ligjit për arsimin fillor. Më tej, mësimitdhënësit dhe nxënësit theksojnë **funksionalitetin e pamjaftueshëm** të

¹ Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Raport i Veçantë i Avokatit të Popullit për shkallën e respektimit dhe realizimit të së drejtës së fëmijëve/nxënësve në shkollat fillore për organizimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve përmes prezantimit të parlamentit studentor dhe Avokatit të Popullit studentor, Shkup, nëntor 2021, në dispozicion në: <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Posebni%20izvestai/2021/Poseben%20izvestaj-Uceniciki%20parlament-11.2021.pdf>

avokatit të nxënësve si model për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në shkollë, ndërsa si formën më funksionale të pjesëmarrjes theksojnë kryetarin/kryetaren e bashkësisë së klasës.

Nxënësit në hulumtim theksojnë se ata ose shokët e tyre të klasës **kanë paraqitur ankesa te Avokati i Popullit** për shkeljen e një të drejte, me çka tregohet se e njohin atë si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Përkatësisht, 32 nxënës ose rreth 5% kanë deklaruar se kanë parashtruar ankesë për një të drejtë të shkelur tek Avokati i Popullit, ndërsa 61 nxënës ose rreth 10% kanë deklaruar se njohin një shok klase dhe/ose shok që ka parashtruar ankesë për një të drejtë të shkelur tek Avokati i Popullit. nëpërmjet prindërve të tyre. Gjithashtu, prindërit kanë qëndrim pozitiv dhe do të parashtronin ankesë tek Avokati i Popullit nëse ndonjë e drejtë e fëmijës së tyre shkelej në shkollë. Kjo është gjithashtu e ndërlidhur me atë që vëren Institucioni i Avokatit të Popullit në Raportet e tij vjetore. Përkatësisht, fëmijët, përkatësisht të rinjtë, për dallim nga më parë, i paraqesin vetë Avokatit të Popullit kërkesë për mbrojtjen e një të drejte të caktuar, ose për të kërkuar këshilla lidhur me një të drejtë të caktuar. Por megjithatë, numri më i madh i kërkesave parashtrohet nga prindërit/kujdestarët apo të afërmit e tjerë, shkollat apo organizatat qytetare. Megjithatë, shifrat tregojnë se roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ende nuk është promovuar mjaftueshëm.

Gjithë përfshirja në shkolla nuk është zbatuar siç duhet, siç parashihet me Ligjin për arsimin fillor dhe konceptin për arsim gjithëpërfshirës. Ndonëse shkollat bëjnë përpjekje për të siguruar qasje dhe materiale mësimore për këtë kategori nxënësish, për fat të keq, sipas nxënësve, shkollat nuk kanë tualete të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara dhe as nuk vendosin tabela në dysheme dhe mure për personat me shikim të dëmtuar. Shkollat pjesërisht ofrojnë kushte për mësimin e gjuhëve të bashkësive etnike. Nxënësit (61 %) tregojnë se shkolla nuk ka materiale për mësimin e gjuhëve të bashkësive etnike në mjedisin shkollor, kurse më shumë se gjysma e nxënësve (52,6 %) besojnë se biblioteka e shkollës nuk ka literaturë në gjuhët e bashkësive etnike në mjedisin shkollor

SIGURI DHE DHUNË

Brenda kësaj fushe tematike, perceptimet, qëndrimet, njohuritë dhe përvojat e fëmijëve, mësimitdhënësve dhe prindërve për ekzistimin e llojeve të ndryshme të dhunës në shkollë, duke përfshirë dhunën në internet, të cilat fëmijët shfaqen si viktimë të dhunës dhe si dhunues, reagimi si dhe mekanizmat për raportimin e dhunës në shkollë

Hulumtimi tregoi se në **shkollat fillore ka dhunë**. Këtë e konfirmojnë 43.4% e nxënësve, ndërsa mësimitdhënësit, edhe pse në një përqindje më të vogël, përsëri konfirmojnë se dhuna është e pranishme në shkollë. Shqetësues është fakti se nga gjithsej 648 nxënës të përfshirë në hulumtim, 298 nxënës ose 46% janë shprehur se kanë qenë viktimë të dhunës. Për shumicën e nxënësve (40.7%), **forma më e zakonshme e dhunës** është dhuna verbale, e ndjekur nga lëndimi fizik dhe abuzimi emocional. Fakti që nxënësit deklarohen ndryshe për ekzistencën e dhunës në situata të ndryshme tregon se nxënësit ende nuk dinë të njohin lloje të ndryshme të dhunës së bashkëmohatarëve ose nuk ndihen të sigurt për të deklaruar se dhuna ekziston. Mësimitdhënësit dhe prindërit konsiderojnë se llojet më të përhapura të dhunës janë dhuna sociale dhe ajo verbale. Sipas gjetjeve për të tre grupet e të anketuarve, **arsyet e dhunës** janë shumë të ngjashme: dëshmimi i forcës, problemet e sjelljes si dhe shfaqja e dominimit ndaj të tjerëve dhe xhelozia.

Sipas të tre grupeve të të anketuarve, si djemtë ashtu edhe vajzat paraqiten si **viktimë të dhunës së bashkëmohatarëve**. Këtë e deklarojnë 59.1% e nxënësve, 75.4% e mësimitdhënësve dhe 80% e prindërve. Sipas nxënësve, një fëmijë që më së shpeshti është i ekspozuar ndaj dhunës është një fëmijë i tërhequr/introvert, më pas një fëmijë që vjen nga një familje e varfër, më pas një fëmijë me aftësi të kufizuara. Dhe prindërit kanë qëndrim identik, ndërsa mësimitdhënësit theksojnë se ndër fëmijët më të ekspozuar ndaj dhunës janë edhe fëmijët hiperaktivë. Arsyet se përse aftësia e kufizuar, gjendja socio-ekonomike, d.m.th varfëria shfaqet si faktor dhune, kurse të varfrit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara janë objektiv i dhunuesve, janë çështje që meritojnë vëmendje të veçantë dhe analizë më të thellë.

Sipas gjysmës së nxënësve, djemtë janë **autorët më të shpeshtë të dhunës**, ndërsa pjesa e mbetur prej 44% e nxënësve, si dhe mësimitdhënësit dhe prindërit, besojnë se djemtë dhe vajzat kryejnë dhunë në mënyrë të barabartë. Sipas nxënësve, profili dominues i autorëve të dhunës janë fëmijët e familjeve të pasura, ndërsa sipas mësimitdhënësve dhe prindërve fëmijët hiperaktivë. Si autorë të dhunës në të tre grupet e të anketuarve përmenden edhe fëmijët me nota të dobëta.

Sa i përket **reagimit të drejtuesve të shkollave** në rastet e dhunës, mësimitdhënësit dhe nxënësit kanë qëndrime të ndryshme. Gjegjësisht, më shumë se një e treta e nxënësve (37.2%) besojnë se shërbimet përgjegjëse në shkollë nuk reagojnë plotësisht në mënyrë adekuate dhe të shpejtë ndaj rasteve të dhunës. Nga ana tjetër, pothuajse dy të tretat e mësimitdhënësve deklarojnë se autoritetet në shkollë reagojnë në mënyrë të duhur dhe të shpejtë në rastet e dhunës. Prindërit janë të ndarë për këtë çështje. Kjo gjendje e gjetjeve tregon se qasja dhe rregullat e procedurës në rastet e dhunës nuk janë të njohura sa duhet si për nxënësit ashtu edhe për prindërit.

Sipas mësimitdhënësve, **mekanismi më funksional për denoncimin e dhunës** është denoncimi te kujdestari i klasës (82%), më pas raportimi te pedagogu (72%), si dhe raportimi te drejtori (37%). Për më tepër, shumica e mësimitdhënësve (85.8%) deklarojnë se do ta raportonin dhunën ndaj nxënësve te Avokati i Popullit nëse mendojnë se rasti nuk mund të zgjidhet brenda shkollës. Pothuajse gjysma e prindërve nuk e dinë nëse shkolla ku mëson fëmija i tyre ka hartuar **politika dhe rregullore** për parandalimin dhe pengimin e dhunës. Veçanërisht shqetësues është fakti që 64% e mësuesve nuk e dinë nëse ka politika dhe rregullore për parandalimin dhe pengimin e dhunës në shkollën e tyre.

Vetëm një pjesë e vogël e mësimitdhënësve (11.4%) marrin pjesë vazhdimisht në trajnime për parandalimin dhe pengimin e dhunës në shkolla (më shumë se 3 trajnime) në 3 vitet e fundit. Pothuajse gjysma (44.3%) nuk kanë marrë pjesë kurrë në trajnime të tilla, ndërsa e njëjta përqindje 44.3% kanë marrë pjesë në një deri në dy trajnime në tre vitet e fundit. Prindërit kryesisht nuk ishin të përfshirë në trajnime të tilla. Kjo temë e trajnimit është pjesë e Katalogut të trajnimeve të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, por trajnime të tilla shpesh organizohen përmes projekteve të mbështetura nga donatorë ndërkombëtarë dhe vendorë.

Për sa i përket **sigurisë së nxënësve në hapësirën kibernetike**, është interesant fakti se fëmijët dhe prindërit kanë qëndrime të ndryshme, veçanërisht në lidhje me përdorimin e internetit. Kështu, më shumë se gjysma e nxënësve (56%) deklarojnë se nuk kanë ndalim apo kufizim në përdorimin e internetit, ndërkohë që shumica e prindërve vendosin ndalime apo kufizime për përdorimin e internetit të fëmijës së tyre. Shqetësues është konstatimi se përdorimi i internetit nga nxënësit është kryesisht për argëtim dhe lojëra (29.6%) ose për komunikim me miqtë (25%). Vetëm 13.9% e përdorin internetin për mësim dhe kërkime.

Shumica e nxënësve mund të njohin **ngacmimet në internet**, por disa nxënës ende nuk mund të njohin ngacmimet në internet, siç është komunikimi i papërshtatshëm nga persona të njohur ose të panjohur. Analiza tregon se një pjesë shumë e vogël e nxënësve janë ngacmuar online vitin e fundit. Mësimitdhënësit dhe prindërit e njohin ngacmimin në internet, por në këtë rast komunikimi i mirë me fëmijët është thelbësor në mënyrë që dhuna e mundshme dixhitale të njihet dhe raportohet siç duhet.

REKOMANDIME KRYESORE

Duke marrë parasysh gjetjet dhe përfundimet e hulumtimit të kryer, rekomandohet:

- ❖ Të vazhdohet **me trajnime dhe informacione të vazhdueshme dhe të fokusuara për Konventën dhe për të drejtat e fëmijës** në të tre grupet e të anketuarve. Trajnimet duhet të jenë gjithëpërfshirëse si në aspektin e përmbajtjes ashtu edhe në aspektin e përfshirjes së të gjithë faktorëve të shkollës dhe të gjithë fëmijëve. Një fokus i veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit për të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë në vendimmarrje.
- ❖ Shkollat dhe mësimdhënësit duhet të mundësojnë **informim dhe njohjen e fëmijëve me të gjithë mekanizmat përmes të cilëve realizohen të drejtat e fëmijës** në kontekstin shkollor, si dhe mekanizmat përmes të cilëve nxënësit kanë mundësi të raportojnë shkeljet e të drejtave. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rolit të shërbimeve profesionale dhe avokatit të nxënësve në situata të shkeljes së të drejtave të nxënësve, në mënyrë që nxënësit, por edhe prindërit, të njihen më mirë me atë që është në kompetencë të shërbimeve profesionale për të forcuar besimin në ato..
- ❖ **Të vazhdohet me përfshirjen e më shumë përmbajtjeve tematike për Konventën** në kuadrin ekzistues, por edhe në lëndë të tjera dhe aktivitete të lira studentore.
- ❖ Njohja me të drejtat e fëmijës duhet të përfshihet si një **aspekt i qartë i edukimit fillestar të mësimdhënësve në fakultetet e mësimdhënies** që t'u mundësojë të gjithë mësimdhënësve të njihen me atë që do të thotë një qasje e bazuar në të drejtat e fëmijës dhe çfarë do të thotë të zbatohet parimi i interesit më i mirë i fëmijës në punën e tyre (të ardhshme) dhe praktikën mësimore.
- ❖ Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit të vendosin **një kontroll më të madh mbi zbatimin e dispozitave të nenit 65 të Ligjit për arsimin fillor**, që të sigurohet që pjesëmarrja e nxënësve të zbatohet në thelb në praktikë. Njëkohësisht, themelimi i organeve përfaqësuese të nxënësve në shkolla (Kryetari i klasës, Parlamenti i nxënësve) si dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave (avokat i nxënësve) duhet të jenë në përputhje dhe zbatimin konsekuent të Udhëzuesit për pjesëmarrjen e nxënësve, organizimin e nxënësve dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës në shkollat fillore.
- ❖ Të mbështeten shkollat fillore në zbatimin praktik të së drejtës së fëmijëve për të marrë pjesë në vendimmarrje duke ofruar **mbështetje të vazhdueshme financiare, teknike, mentoruese dhe mbështetje tjetër sistematike** në ngritjen e parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve. Shkollat në kuadër të buxheteve të tyre mund të ndajnë edhe fonde të caktuara për punën e parlamentit të nxënësve, si dhe të ofrojnë një dhomë të veçantë për funksionimin e parlamentit dhe avokatit të nxënësve. Parlamenti i nxënësve duhet të zhvillohet në një model dinamik që do të jetë i hapur për përfshirjen e të gjithë nxënësve të interesuar.
- ❖ Të vazhdojë **partneritetin me organizatat e shoqërisë civile** dhe mbështetjen e tyre për shkollat përmes programeve, trajnimeve dhe një sërë aktiviteteve të tjera që synojnë forcimin e kapaciteteve të të gjithë aktorëve për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve.
- ❖ Nxënësit dhe i gjithë kadri duhet të **njihen më shumë me rolin dhe mandatin e Avokatit të Popullit**, si dhe me mënyrën dhe formën e paraqitjes së ankesës për një të drejtë të shkelur. Shkollat inkurajohen që të përdorin më shumë mekanizmin e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet shkollore.

- ❖ Rekomandohet që drejtuesit e shkollave, kadri mësimor, shërbimet profesionale dhe prindërit të bashkëpunojnë me qëllim **të zbatimit më mirë të Konceptit për arsimin gjithëpërfshirës** dhe të përgatisin programe për forcimin e gjithë përfshirjes së shkollave. Për financimin e programeve të tilla, rekomandohet që shkollat të bashkëpunojnë me bashkitë dhe bizneset dhe kompanitë lokale.
- ❖ Byroja e Zhvillimit të Arsimit të vazhdojë të ofrojë **trajnime të mësimdhënësit për tema në fushën e dhunës**.
- ❖ Byroja për Zhvillimin e Arsimit duhet t'u prezantojë në detaje të gjitha shkollave dhe të gjitha palëve të interesuara ***Udhëzimin për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së një nxënësi që është viktimë e çdo forme dhune, abuzimi dhe braktisje***. Në të njëjtën kohë, Inspektorati Shtetëror i Arsimit duhet të kontrollojë rregullisht zbatimin e procedurave të përcaktuara në Udhëzime.
- ❖ Shkollat duhet të **angazhohen për monitorim dhe raportim të rregullt të incidenteve të dhunës**, jo vetëm tek institucionet kompetente (komuna, MASH, Qeveri) por përgjithësisht për t'i vënë në dispozicion të publikut këto gjetje përmes një seksioni të veçantë në raportet vjetore të shkollave.
- ❖ Raportet vjetore dhe aktivitetet e planifikuara të *Trupit koordinues nacional për mbrojtjen dhe parandalimin e fëmijëve nga abuzimi dhe braktisja* duhet të **jenë publik dhe lehtësisht të qasshme** për të pasur një pasqyrë të tendencave të shfaqjes, por edhe në mënyrat e trajtimit dhe parandalimit të dhunës.
- ❖ Rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve **për llojet e dhunës në internet** dhe kryerja e trajnimeve për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale në internet përmes bashkëpunimit me ekspertë të fushës dhe me ndihmën e organizatave civile.
- ❖ Krijimi i udhëzimeve dhe mjeteve për rritjen e **përdorimit të internetit në realizimin e përmbajtjeve mësimore përmes kërkimit**, gjenerimit të informacionit dhe të dhënave dhe përdorimit të tyre në mësimdhënie.